



A.nr.1345/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1345/2025, të datës 10.07.2025, të parashtruar nga ankuesi F.F, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Hajzer Salihu nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datën 12.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1345/2025, e datës 10.07.2025, e parashtruar nga ankuesi F.F.

A r s y e t i m

Ankuesi F.F (*tutje referuar vetëm ankuesi*), përmes përfaqësuesit të tij më autorizim më datë 10.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit nën shenjen ref.02/Nr.13, të datës 20.06.2025, të u.d. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë lidhur me mos kompensimin material, me pretendimet së akti i kontestuar përmban shkelje ligjore procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje vetëm Këshilli) bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (*tutje MINT*), ndërsa, kjo e fundit, më datë 01.08.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4619/2025 të datës 10.07.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Ref.02/Nr.133 të datës 20.06.2025; Emailin e datës 09.07.2025 nga DBNJ MINT për përfaqësuesin e ankuesit; Emailin e datës 09.07.2025 nga S.Z për DBNJ MINT; Kërkesën për kompensimin e ankuesit e datës 18.06.2025; Vendimin me numër protokolli 1186 të datës

10.06.2025 të DMZP-së; Vendimin A.nr.751/2021 të datës 19.05.2025 të KPMSHCK-së; Vendimin me Nr. 20/62 të datës 28.08.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Autorizimin e datës 17.06.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 01.08.2025; Akt Emërtimeve të datës 10.06.2025; Vendimin me Nr. 0462/2021 të datës 22.07.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Vendimin me numër protokolli 5662/2025 të datës 22.08.2025 për shtyrje të afatit të vendosje së ankesës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është bazuar, *sepse:*

Gjendja e fakteve

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë kjo gjendje faktike:

- Ankuesi sipas Vendimit me Nr. 20/62, të datës 28.08.2018, të Qeverisë së Republikës së Kosovës është emëruar në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës me mandat tre (3) vjeçar.
- Më datë 26.05.2021, Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka iniciuar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit pranë Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, me dyshimin për shkelje të rënda disiplinore.
- Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë më Vendimin Nr. 0431/2021, të datës 13.07.2021, ka pezulluar ankuesin nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës, ndërsa, pas shtyrjes së afatit për vendosje dhe 30 ditë, më Vendimin Nr.0462/2021, të datës 22.07.2021, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore Largim nga Shërbimi Civil.
- Ankuesi kundër Vendimit Nr. 0462/2021, të datës 22.07.2021, kishte parashtruar ankesë më datë 23.08.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mirëpo, për shkak të mungesës së kuorumit Këshilli nuk ka mundur të shqyrtoj ankesën e ankuesit, duke e njoftuar të njëjtin për arsyet e mos shqyrtimit të saj dhe rrugëve ligjore që mund të ndjek.
- Ankuesi ka iniciuar konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.2189/2021, të datës 20.05.2024, ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesi duke anuluar njoftimin e datës 31.08.2021 dhe duke e detyruar Këshillin të shqyrtoj ankesën e datës 23.08.2021.
- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.2189/2021, më datë 20.05.2024, më Vendimin A.nr.751/2021, ka aprovuar ankesën e ankuesit të datës 23.08.2021, duke e shfuqizuar Vendimin me Nr. 0462/2021 të datës 22.07.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë dhe duke detyruar MINT-in që të bëjë kompensimin e pagave për ankuesin nga data 13.07.2021 deri më datë 28.08.2021, ndërsa, ka obliguar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të bëjë sistemimin e ankuesit në kategori të mesme drejtuese.
- Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më Vendimin numër protokolli 1186, të datës 10.06.2025, ankuesin e ka sistemuar në pozitën Drejtor i Departamentit për Metrologji Ligjore në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës.
- Ankuesi më datë 18.06.2025, ka parashtruar kërkesë tek MINT për kompensimin të mjeteve materiale të gjysmë pagës së mbetur nga muaji korrik dhe pagën e muajit gusht 2021 si pozitë e kategorisë së lartë

drejtuese, tri paga të kategorisë së lartë drejtuese nga data 28.08.2021 deri më datë 28.11.2021 dhe 43 paga të kategorisë së mesme drejtuese nga data 29.11.2021 deri më datë 10.06.2025.

- Sekretari i Përgjithshëm i MINT me Vendimin Re.02/Nr.133, të datës 20.06.2025, ankuesit i ka bërë kompensimin e pagës nga data 13.07.2021 deri më datë 28.08.2021, kurse, sipas emailit të datës 09.07.2025, përfaqësuesi i palës ankuese është njoftuar se kompensimi nuk mund të bëhet për shkak që nuk është mbështetur në vendimin e KPMSHCK-së.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin nën shenjen ref.02/Nr.13, të datës 20.06.2025 të u.d Sekretares së Përgjithshme të MINT, me pretendimin së palës ankuese i takon kompensimi i pagave të kategorisë së mesme drejtuese nga data 29.11.2021 deri më datë 10.06.2025. Kërkon që të kompensohet për 3 paga të kategorisë së nivelit të lartë drejtues nga data 29.08.2021 deri më datë 28.11.2024 dhe 43 paga të kategorisë së mesme drejtuese nga data 29.11.2021 deri më datë 10.06.2025.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në kuptim të pretendimeve ankimore thekson faktin se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me ankesën e ankuesit kundër Vendimit Nr. 0462/2021 të datës 22.07.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, ka vendosur me datë 19.05.2025 përmes Vendimit A.nr.751/2021 të datës 19.05.2025, ashtu që ka shfuqizuar Vendimin Nr.0462/2021 të datës 22.07.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë dhe mbi këtë bazë ankuesit i është njohur e drejta e kompensimit të pagës nga data 13.07.2021 deri më 28.08.2021, pra nga data e pezullimit e deri me datë kur ankuesit i ka përfunduar mandati i rregullt si Drejtor i Përgjithshëm i AMK-së sipas Vendimit për emërim Nr. 20/62, të datës 28.08.2018, andaj, edhe organi i punësimit ka bërë kompensimin e ankuesit në pajtim të plotë më pikën III të dispozitivit të Vendimit A.nr.751/2025.

Nuk qëndron pretendimi i ankuesit për kompensim të pagave të drejtuesit të lartë (3 paga) dhe drejtuesit të mesëm pas datës 28.08.2021 e deri në sistemimin e ankuesit nga DMZP-ja, sepse për shkak të rrethanave ligjore si me sipër, në rastin e ankuesit nuk kemi të bëjmë me përfundim të rregullt (me kohë) të mandatit sipas fuqisë së ligjit (ex lege), kështu që, në rastin e ankuesit nuk ka mundur të aplikohet paragrafi 5 i nenit 42 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe as kompensimi siç përcaktohej më paragrafin 7 dhe 8 të këtij ligji. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të drejtat ligjore të ankuesit pas përfundimit të mandatit konsiderohen se rrjedhin nga data e Vendimit të Këshillit A.n.nr.751/2025 të datës 19.05.2025, kështu që duke qenë së ankuesi më datë 10.06.2025 është sistemuar në pozitë të mesme drejtuese, atëherë, ankuesi vazhdon të paguhet për pozitën ku është sistemuar.

Përmbledhur si më lartë, e duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1345/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Hajzer Salihu;
- MINTI: Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMSHCK-së.